


# Qasja në dokumente publike

Rastet kur lejohet qasja në dokumente publike



Dokumenti publik i kërkuar ka të bëjë me **shpenzimet e parasë publike**;

Dokumenti publik lidhet me **zbatimin e funksioneve publike ose marrëdhëniet e punësimit të zyrtarëve publik**;

Përveç në rastet kur ka të dhëna personale të mbrojtura apo kur saktësohet ndryshe në ligjet përkatëse;



Dokumenti publik i kërkuar ka të bëjë me **mjedisin, mbeturinat, substancat e rezikshme ose informata të raporteve të sigurisë në mjedis**, ashtu si janë të parapara me ligjin përkatës për mbrojtjen e mjedisit.




Grupi për Studime  
Juridike dhe  
Politike

Mbështetur nga

**KFOS**  
Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur  
Kosovo Foundation for Open Society  
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo

# Qasja në dokumente publike

Kufizimi i të drejtës për qasje në dokumente publike ushtrohet vetëm për qëllime të mbrojtjes së:



- 1 jetës, shëndetit dhe të sigurisë publike
- 2 sigurisë shtetërore, mbrojtjes dhe të marrëdhënieve ndërkombe;
- 3 parandalimit, hetimit dhe ndjekjes së veprave penale në rastet kur publikimi i dokumenteve publike mund të dëmtojë procesin e hetimit;
- 4 hetimet disiplinore, në rastet kur publikimi i dokumenteve publike mund të dëmtojë procedurën disiplinore;
- 5 inspektimit, kontrollimit dhe mbikëqyrjes nga institucionet publike në rastet kur trajtojnë informacion të klasifikuar
- 6 të drejtës për privatësi dhe e drejta e fshirjes ('E drejta për t'u harruar');
- 7 konfidentialitetit komersial siç janë sekretet e biznesit, sekretet profesionale apo të kompanisë;
- 8 dokumenteve për të cilat institucioni publik apo palët e treta gëzojnë të drejtat e pronësisë intelektuale;
- 9 politikave ekonomike, monetare dhe këmbimore të shtetit;
- 10 konfidentialitet statistikor;
- 11 barazisë së palëve në procedura gjyqësore dhe administrimin efikas të drejtësisë;
- 12 diskutimeve brenda apo ndërmjet institucioneve publike lidhur me shqyrtimin e ndonjë çështjeje, e cila përbën dokument të klasifikuar.



Grupi për Studime  
Juridike dhe  
Politike

Mbështetur nga

**KFOS**  
Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur  
Kosovo Foundation for Open Society  
Kosovska Fondacija za Otvorno Društvo

# Qasja në dokumente publike

## Kërkesa për qasje në dokumente publike



1

Kërkesi mund ta bëjë kérkesen me shkrim, në formë elektronike apo verbalisht. Nëse kërkesa bëhet verbalisht, zyrtari përgjegjës detyrohet ta hartojë kérkesën me shkrim. Nëse kërkesa bëhet në formë elektronike ajo konsiderohet si kérkesë me shkrim.



2

Nëse kërkesa nuk gjindet në institucionin përkatës atëherë brenda një afati 7 ditor, institucioni duhet ta udhezojë atë që t'i drejtohet Agjencisë, e cila poashtu brenda një afati 7 ditor prej momentit që i është dorëzuar duhet të njoftojë kérkuesin.



3

Afati për trajtimin e një kérkesë është 7 ditë (qoftë për aprovim, refuzim të plotë ose të pjesshëm) si dhe duhet të informojë kérkuesin për të drejtën që ka për ta rishqyrtuar kérkesën. Kërkesa i dërgohet zyrtarit për qasje në dokumente publike. Zyrtari pas marrjes dhe shqyrtimit të kérkesës identifikon njësinë përkatëse ku gjindet dokumenti dhe e dërgon aty.



4

Sipas praktikës, insitucionet kanë thënë:  
Pas pranimit të kérkesës për QDP, atë kérkesë e drejtojmë në Departamentin, Divisionin apo Njësinë e caktuar, e cila ka të bëjë me dokumentet në të cilat kërcohë qasja. Në ndërkohë gjatë shqyrtimit të kérkesës, nëse paraqitet paqartësi në kérkesë, kérkojmë nga kérkuesi sqarime shtesë rreth kérkesës së tij. Nëse gjatë shqyrtimit të kérkesës shfaqen situate të paqarta juridike, atëherë në këtë rast ç'do herë komunikohet me departamentin ligjor të institucionit në mënyrë që të kemi qartësim, mirëpo nëse kemi të bëjmë me kérkesë për QDP, e cila kérkon implikim të të dhënavë personale apo sensitive, atëherë në këtë situatë në ç'do herë marrim opinion nga agjencia për mbrojtjen e të dhënavë personale.



Grupi për Studime  
Juridike dhe  
Politike

Mbështetur nga

**KFOS**  
Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur  
Kosovo Foundation for Open Society  
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo

# Qasja në dokumente publike

## Shtyrja dhe refuzimi i kërkesës



**1**

Institucioni mund të vazhdojë afatin prej 7 ditësh në 15 ditë nëse kërcohet një numër të madh të dokumenteve apo jashtë institucionit.



**2**

Nëse institucioni ka refuzuar në teresi apo pjesërisht kërkesën për qasje në dokumente publike apo në rast të heshtjes, kërkuar mund t'i drejtohet Agjencisë me ankesë brenda afatit 15 ditëve.

Agjencia, ankesën e pranuar ia komunikon institucionit publik që ka vendosur në lidhje me kërkesën për qasje, i cili duhet që brenda shtatë (7) ditëve të ofrojë përgjigje me shkrim ndaj pretendimeve të ngitura nga ankesi.



**3**

Pasi që Agjencia kontakton institucionin, Agjencia vendosë në lidhje me ankesën në një afat 30 ditor. Agjencia vendosë me një akt të brendshëm për procedurën dhe vendimin.



**4**

Agjencia mund ta aprovojë në tërësi ankesën dhe të ndryshojë vendimin e institucionit. Mund ta aprovojë pjesërisht kërkesën dhe ta ndryshojë vendimin e institucionit dhe kerkuesit t'i lejohet qasja pjesërisht.



**5**

Institucioni duhet të veprojë sipas vendimit të Agjencisë në një afat prej 7 ditësh.



**6**

Agjencia poashtu mund ta refuzojë kërkesën por duhet ta njoftojë kerkuesin personalisht me shkrim. Vendimi i Agjencisë është përfundimtar në procedurën administrative, i cili mund të kundërshtohet përmes padisë në gjykatën kompetente për çështje administrative brenda një afati prej 30 ditësh.



Grupi për Studime  
Juridike dhe  
Politike

Mbështetur nga

**KFOS**  
Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur  
Kosovo Foundation for Open Society  
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo